



RUAJTJA E PRIVATËSISË NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"





Përmbajtja

| | |
|--|---|
| RUAJTJA E PRIVATËSISË NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË" | 1 |
| <i>I. Mënyra se si i përdor KUPV të dhënat e mbledhura</i> | 3 |
| <i>II. Personat që paraqesin një kërkesë për informim apo, ankesë pranë KUPV</i> | 4 |
| <i>III. Aksesit në të dhënat personale</i> | 4 |
| <i>IV. Kujt i transferohet informacioni i mbledhur nga KUPV.....</i> | 5 |
| <i>V. Vizitorët në faqen tonë të internetit</i> | 5 |
| <i>VI. Aplikantët për punë, punonjësit aktualë në KUPV.....</i> | 6 |
| <i>VII. Përhapja e të dhënave personale</i> | 8 |
| <i>VIII. Si të na kontaktoni.....</i> | 8 |
| <i>IX. Siguria e informacionit</i> | 8 |

RUAJTJA E PRIVATËSISË NË

KOLEGJIN UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

Kolegji në cilësinë e kontrolluesit realizon mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

I. Mënyra se si i përdor KUPV të dhënat e mbledhura

Të dhënat e mbledhura nga KUPV grumbullohen, përpunohen dhe ruhen në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe me përcaktimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KUPV mbledh dhe përpunon informacion për studentët të cilat përdoren vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime dhe përpunimi të bëhet në përputhje me këto qëllime.

Të dhënat personale të studentëve përpunohen dhe përditësohen vetëm në përputhje me qëllimin e përpunimit të tyre dhe mbahen në formën që lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave brenda kohës që i korrespondon qëllimit.

Në faqen e internetit www.unipavaresia.edu.al në zonën e studentëve ruhen dhe përpunohen të dhëna personale në lidhje me rezultatet akademike të studentëve duke i dhënë akses personal çdo studenti për verifikimin e përparimit të tij akademik në vite por duke garantuar edhe respektimin e të drejtës së privatësisë së tyre në lidhje me të dhënat personale të aksesueshme vetëm prej tyre.

Këto të dhëna sensitive për studentët përpunohen nga sistemi vetëm sipas qëllimi të ligjshëm të përdorimit të tyre dhe i shërbejnë rritjes së transparencës së KUPV në raport me studentët dhe në raport me personelin akademik të universitetit.

Personeli akademik i KUPV akseson në mënyrë individuale në sistemin <http://217.21.146.186> të dhëna në lidhje me studentët sipas numrave të matrikullimit dhe të

dhënave të tjera të cilat identifikojnë studentët operon duke plotësuar përbri tyre edhe notat e studentëve sipas procesverbalit të mbajtur për kurset përkatëse të ndjekura nga studentët. I gjithë ky proces realizohet nëpërmjet përpunimit automatik të të dhënave nga sistemi duke garantuar konfidencialitetin dhe i shërben rritjes së efikasitetit të funksionimit të procesit mësimor në veçanti të procesit të kontrollit të dijeve duke garantuar besueshmëri dhe transparencë.

Personeli administrativ akseson në llogaritë personale si dhe në adresat elektronike informacionin e transmetuar në sistem duke ruajtur të drejtën e privatësisë si dhe të konfidencialitetit të të dhënave të tyre.

II. Personat që paraqesin një kërkesë për informim apo, ankesë pranë KUPV

Ankesat apo kërkesat për informacion drejtuar KUPV, regjistrohen në një regjistër të veçantë dhe protokollohen në përputhje me ligjin për arkivat dhe trajtohen në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit si dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Regjistrimi i tyre bëhet nga një punonjës i caktuar nga titullari i Insitucionit për këtë qëllim i cili operon në përputhje me standartet e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të regjistruar si dhe të privatësisë së kërkuesit.

Në regjistrin e kërkesave dhe të përgjigjeve publikohet vetëm numri rendor i kërkesës si data e paraqitjes së tyre duke ruajtur qëllimet dhe standartet e ligjit. Të dhënat personale të mbledhura janë vetëm për efekt të shqyrtimit korrekt të ankesës si dhe të hartimit të përgjigjes për ankuesin apo kërkuesin respektiv. Këto të dhëna përpunohen më tej nga punonjës që kanë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit për qëllime të efikasitetit të funksionimit të KUPV apo për qëllime statistikore për të identifikuar numrin e ankesave apo të kërkesave që marrim por jo në mënyrë të tillë për të identifikuar subjektin e tyre.

III. Aksesimi në të dhënat personale

Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" përpiqet që të jetë sa më transparent duke ju dhënë individëve akses në të dhënat e tyre personale që ruhen dhe përpunohen nga KUPV. Individët e interesuar mund të interesohen nëse KUPV mban të dhënat e tyre personale duke dërguar një kërkesë për akses në të dhënat e tyre personale sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rast kerkese për akses kur ne mbajmë të dhënat tuaja personale ju japim një përshkrim të këtyre të dhënave, duke shpjeguar edhe arsyen e mbajtjes dhe përpunimit të tyre si dhe tregojmë se te cili marrës përhapen këto të dhëna duke ruajtur qëllimin e përpunimit të tyre. Në këtë rast kërkesa për akses në të dhënat personale bëhet me shkrim dhe dërgohet me postë në adresë të KUPV dhe i kalon më pas njësisë përgjegjëse për trajtimin e saj sipas objektit të kërkesës dhe natyrës së të dhënave personale për të cilën kërkohet aksesi.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin e kërkesave të individëve për të kërkuar korigjimin e gabimeve në të dhënat personale dhe informacionin në lidhje me ta.

IV. Kujt i transferohet informacioni i mbledhur nga KUPV

Informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga KUPV në lidhje me studentët, personelin akademik dhe atë administrativ i transmetohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për efekt të detyrimeve ligjore të KUPV për të raportuar periodikisht pranë kësaj Ministrie sipas një korrespondence shkresore.

Gjithashtu ky informacion i transmetohet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë apo agjencie të tjera të ngritura në zbatim të ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucinet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Informacioni dhe të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga KUPV transmetohen njësisë të mësipërme duke ruajtur qëllimin e funksionimit të Kolegjit si dhe në përputhje me objektin e funksionimit të këtyre njësive në fushën e arsimit të lartë.

Kompania e mirëmbajtjes së sistemit në KUPV operon në përputhje me termat e kontratës për konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit dhe është përgjegjëse për ruajtjen e konfidencialitetit dhe autenticitetit të të dhënave personale që ruhen dhe gjenerohen nga sistemi.

V. Vizitorët në faqen tonë të internetit

Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" disponon faqen zyrtare të internetit www.unipavaresia.edu.al nëpërmjet të cilës KUPV transmeton dhe mbledh informacione. Nëpërmjet faqes zyrtare KUPV ju vjen në ndihmë studentëve, personelit akademik dhe administrativ si dhe të gjithë personave të interesuar në lidhje me strukturën e KUPV, organigramën, organet dhe autoritetet drejtuese, projektet, aktivitetet e KUPV si dhe në lidhje

me veprimtarinë mësimore kërkimore shkencore akademike që KUPV ushtron në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Për vizitorët e www.unipavaresia.edu.al, sistemi mbledh informacione standarte të cilat kanë të bëjnë me klikimet e artikujve apo të rubrikave në këtë faqe. Ky informacion mblidhet për qëllime statistikore dhe studimi (për të treguar qasjen e vizitorëve, për të parë rubrikat më të ndjeshme dhe për rrjedhojë interesin e subjekteve në lidhje me aktivitetet apo funksionimin e KUPV pa i bërë atë të identifikueshëm).

Ne e mbledhim këtë informacion në mënyrë që të mos identifikojmë asnjë vizitor dhe nuk bëjmë asnjë përpjekje për të gjetur identitetin e vizitorëve apo për ti bërë ata të identifikueshëm.

KUPV nuk përdor dhe nuk lejon përdorimin nga të tretët të mjeteve statistikore analitike për të ndjekur apo për të mbledhur informacione personale që i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e faqes tonë zyrtare. Ne nuk lidhim asnjë të dhënë të grumbulluar nga kjo faqe me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çdo burim që të vijë si pjesë e përdorimit tonë. Nëse do të duam të mbledhim informacione personalisht të identifikueshëm nëpërmjet faqes tonë të internetit, ne do t'ju a bëjmë të qartë rastin kur të mbledhim informacion personal dhe do të shpjegojmë se çfarë kemi ndërmend të bëjmë në lidhje me të.

VI. Aplikantët për punë, punonjësit aktualë në KUPV

Punësimi i personelit akademik, ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ në **Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë"** realizohet në bazë të konkursit publik për vendet e lira të punës të shpallura edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike sipas kërkesave për personel akademik dhe administrativ të Njësisë Kryesore.

Kriteret e punësimit si dhe procedurat e zhvillimit të konkursit janë të përcaktuara Rregulloren dhe Statutin e KUPV. Dokumentat që duhet të përmbajë paketa e aplikimit të çdo kandidati janë të miratuara në Statutin dhe në Rregulloren e Kolegjit e cila është e publikuar në faqen zyrtare të Universitetit.

Të dhënat personale të aplikantëve subjekt i të dhënave personale pas aplikimit me postë zyrtare përpunohen paraprakisht nga Zyra e Burimeve Njerëzore e KUPV e cila dorëzon me procesverbal dosjet e aplikimit, Komisioneve, ad- hoc të vlerësimit të kandidatëve të ngritur me urdhër të Dekanit të Fakultetit ose autoriteteve drejtuese sipas rregullores.

Përpunimi i të dhënave personale nga DBNJ dhe Komisionet ad hoc të vlerësimit të kandidatëve (KVK) bëhet me qëllim që të verifikohet përputhshmëria e informacionit të formularit të aplikimit me dokumentacionin e paktetës, duke përfshirë edhe rillogaritjen e notës mesatare të kandidatit. Komisionet ad hoc bëjnë renditjen e kandidatëve në rendin zbritës për çdo specialitet sipas pikëve të grumbulluara nga paketa e aplikimit dhe nga intervista në bazë të formularëve të vlerësimit.

Lista e kandidatëve që do të intervistohen së bashku me datën, vendin dhe orën e intervistimit sipas rendit zbritës të pikëve publikohet në faqen zyrtare të universitetit www.unipavaresia.edu.al . Aplikantët që nuk do të kalojnë në fazën e intervistimit së bashku me arsyen përkatëse të skualifikimit informohen me e-mail personal nga ZBNJ.

Kandidatët që aplikojnë për vende të lira pune në KUPV kanë të drejtën e aksesit në lidhje me formularet e vlerësimit të aplikimeve dhe për çdo paqartësi, probleme eventuale ose për korigjim të të dhënave në rast të gabimeve në llogaritje të mesatares së notave etj, mund ti drejtohen me shkrim KVK ose ZBNJ. Përpunuesit e të dhënave ZBNJ dhe KVK janë të detyruara të përgjigjen me shkrim brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e të gjithë informacionit të përpunuar edhe pas përfundimit të funksionit, detyrës së tyre pranë universitetit. Ata mbajnë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi në rastet e mospërbushjes së këtij detyrimi.

KVK dorëzojnë me procesverbal dosjet e aplikimit të kandidatëve fitues dhe atyre jofitues pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Dosjet e kandidatëve jofitues mund të tërhiqen mbas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga aplikuesit pranë ZBNJ. Dosjet e kandidatëve fitues arshivohen në ZBNJ dhe përdorimi i të dhënave të tyre lejohet vetëm me urdhër të autoriteteve drejtuese apo operatorëve të autorizuar.

ZBNJ merr masa për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të besueshmërisë së të dhënave personale të aplikantëve dhe të gjithë personelit të universitetit duke ndaluar përhapjen e tyre të paautorizuar si dhe hyrjen në mjediset e përpunuesit të personave të paautorizuar.

VII. Përhapja e të dhënave personale

KUPV nuk përhap të dhënat personale pa marrë më parë pëlqimin tuaj me përjashtim të rasteve të hetimit të ankesave apo kur kërkohet informacion nga institucionet e prokurorisë në lidhje me çështje të caktuara në përputhje me qëllimin e funksionimit të IAL-ëve me përjashtim të rasteve kur dhënia e informacionit organeve apo institucioneve të caktuara është detyrim ligjor për të shmangur një veprë penale apo në kuadër të hetimit të tyre nga instancat përkatëse.

VIII. Si të na kontaktoni

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën e privatësisë mund të na kontaktoni me email në adresën info@unipavaresia.edu.al.

IX. Siguria e informacionit

KUPV aplikon standartet më të larta të mbledhjes, përpunimit, transmetimit dhe ruajtjes së informacionit duke garantuar mbrojtjen e informacionit nga çdo përdorim i paautorizuar, ndryshimi, zbulimi apo shkatërrimi qoftë aksidental qoftë i qëllimshëm.

Këto standarte konsistojnë në përdorimin e sistemit të teknologjisë me qëllim ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit gjatë kontrollit të tij duke marrë parasysh zhvillimet në teknologji si dhe kostot e zbatimit të saj për të arritur një nivel sigurie të përshtatshëm për natyrën e informacionit dhe të dëmit që mund të rezultojë nga një shkelje e sigurisë.

Siguria e informacionit garantohet edhe nëpërmjet detyrimit të punonjësve të mbyllin kompjuterat e tyre, dollapët, kasafortat dhe zyrën, në të cilën janë ruajtur të dhënat personale sipas përshkrimit të punës që ata kryejnë, sa herë që largohen nga vendi i tyre i punës detyrimit të punonjësve të mos largohen nga mjediset e punës kur ka të dhëna të mbrojtura në tavolinë dhe ndodhen në prani të personave të cilët nuk janë të punësuar nga ana e KUPV-së si dhe të detyrimit të punonjësve të mos mbajnë në monitor të dhëna personale, kur është i pranishëm një person i paautorizuar dhe sidomos në vende jo publike;

Gjithashtu siguria e informacionit garantohet edhe nga personeli i KUPV-së i cili karakterizohet nga integriteti personal dhe profesional me përgjegjësi për mbrojtjen e tij dhe për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit për të cilin ka akses gjatë ushtrimit të funksioneve të tij në bazë të ligjit duke garantuar përhapjen e tij vetëm për institucione dhe për qëllime të ligjshme.

Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit nga ana e personelit është e materializuar nga nënshkrimi nga secili punonjës i KUPV-së i deklaratës së konfidencialitetit nëpërmjet të cilës marrin përsipër të mos përdorin dhe të mos i transmetojnë personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale që vihen në dijeni gjatë ushtrimit të punës në KUPV-së përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose kur merr autorizimin përkatës nga subjekti i të dhënave. Detyrimi i konfidencialitetit vlen gjatë gjithë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me KUPV.